VENDIM
Nr.1714, datë 29.12.2008

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.600, DATË 12.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE DHE TË FUNKSIONARËVE POLITIKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20, të ligjit nr.8550 datë 18.11.1999 "Për statusin e deputetit", të nenit 30 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 12, të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", të nenit 18 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë", të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.600, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës "ë" të pikës 1, shtohet shkronja "f", me këtë përmbajtje:

"f) gjykatësit e gjykatave të apelit dhe të gjykatave të rretheve gjyqësore.".

b)Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4.Listat për marrjen e kredive miratohen nga titullarët e ministrive e të institucioneve përkatëse, brenda numrit të miratuar nga Kryeministri, dhe më pas dërgohen në bankën e përzgjedhur, e cila është e detyruar të respektojë renditjen e përcaktuar në këto lista.".

c)Në pikën 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Fjalia e fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kryeministri, në përputhje me kërkesat e paraqitura nga ministritë e institucionet përkatëse, miraton numrin e përfituesve të kredive, për çdo institucion.".

ii)Në fund të kësaj pike shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Kërkesat paraqiten vetëm pasi ministritë e institucionet përkatëse të kenë shqyrtuar dhe verifikuar plotësimin e kritereve, të parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi, dhe të shoqërohen me dokumentacionin përkatës, të paraqitur nga subjektet, që përfitojnë të drejtën për strehim a sipërfaqe shtesë banimi.".

2.Ngarkohen ministrat dhe drejtuesit e institucioneve qendrore të pavarura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha